

**INFORMACION PËR GJENDJEN ME RASTET ME PERTUSIS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË  
SË VERIUT NË VITIN 2024, DERI MË 18.04.2024**

**Të dhëna javore**

Në periudhën 12-18.04.2024 në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 46 raste të reja me pertusis, 4,5% më shumë se javën që shkoi (n=44). Numri më i madh i tyre (37) janë raportuar në Shkup, në Manastir 3, në Kumanovë 2, Kratovë, Tetovë, Kriva Pallankë, Prilep dhe Strumicë nga 1. (Tabela 1)

Mosha e të prekurve sillet nga 1 muaj deri në 73 vjet, ndërsa numri më i madh i përkasin grupmoshës 10-14 vjet (n=14).

Nga rastet e reja 9 raste janë hospitalizuar.

*Tabela 1. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 12-18.04.2024*

Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë
Shkup	37
Karposh	8
Kisella Voda	6
Aerodrom	5
Qendër	5
Gazi Baba	2
Çair	2
Butel	2
Haraçina	2
Gjorçe Petrov	1
Saraj	1
Shuto Orizare	1
Petrovec	1
Studenica	1
Manastir	3
Kumanovë	2
Prilep	1
Kriva Pallankë	1
Tetovë	1
Strumicë	1

**Të dhëna kumulative**

Në vitin 2024, deri me datë 18.04.2024, në ISHP të RMV-së janë regjistruar gjithsej 489 raste me pertusis, me një incidencë prej 26,6/100,000 banorë.

Shpërndarja e rasteve sipas vendbanimit tregon se numri më i madh i të sëmurëve jetojnë në Shkup - 392 (80,2%) në shtatëmbëdhjetë komuna të ndryshme. (Tabela 2).


27 të sëmurë janë regjistruar në Kumanovë, ndërkohë që raste janë regjistruar edhe në 15 qytete të tjera.

*Tabela 2. Shpërndarja gjeografike e rasteve me kollë të keqe në RMV, 2024*

Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë	Qyteti/Komuna	numri i personave të sëmurë
Shkup	392	Tetovë	18
Aerodrom	100	Tetovë	7
Karposh	78	Tearcë	5
Kisella Voda	46	Zhelinë	3
Qendër	34	Brvenicë	2
Gjorçe Petrov	28	Bogovinjë	1
Çair	27	Gostivar	5
Gazi Baba	18	Gostivar	4
Butel	16	Vrapçisht	1
Saraj	11	Strumicë	3
Studenica	11	Strumicë	2
Shuto Orizare	8	Bosilovë	1
Petrovec	5	Koçan	3
Çuqer Sandevë	3	Kratovë	3
Sopishte	2	Kriva Pallankë	3
Haraçina	2	Prilep	2
Ilinden	2	Dollnen	2
Zelenikovë	1	Strugë	2
Kumanovë	27	Dibër	2
Kumanovë	26	Probishtip	2
Likovë	1	Veles	2
Manastir	22	Kavadar	1
Manastir	21	Gjevgjeli	1
Mogilla	1	Kërçovë	1

Incidencë më e lartë prej 64,6/100.000 është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë e lartë është regjistruar edhe në Kratovë (39,8/100.000), Manastir (23,6/100.000) dhe Kumanovë (21,8/100.000). (Hartogrami)

*Hartogrami. Incidenca në 100.000 banorë sipas QSHP/NJR, kolla e keqe në RMV, 2024*




Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, personat e prekur janë nga 1 muaj deri në 78 vjet (mesatarja 11,8 vjet). Numri më i madh i të sëmurëve janë nga 10-14 vjet (n=135; 27,6%) pastaj vijnë ata deri në 4 vjet (n=75, 25,8%), (15,3%) janë nën 1 vjet, (10,4%) ose 51 janë nga 1 deri në 4 vjet.

Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet (I=453,6/100.000). (Grafiku 1).


Shpërndarja sipas gjinisë tregon se 243 të sëmurë janë meshkuj, ndërsa 246 femra, raporti mes tyre është 1:1.

**Grafiku 1.** Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe (n=489) sipas moshës, në RMV, 2024 година



Lakorja epidemike tregon se shfaqja e rasteve të reja të kollës së keqe fillon në javën e parë të vitit 2024. Sipas të dhënave vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të rasteve në bazë javore, deri në javën e 12-të. Nga java e 12-të, me variacione të vogla, numri i rasteve herë rritet dhe herë zvogëlohet.


**Grafiku 2.** Shpërndarja e të sëmurëve me kollë të keqe (n=489) sipas javës së raportimit (deri më 18.04.2024 nga java e 16), në RMV, 2024



Sa i përket statusit të vaksinimit, 294 (60,1%) e pacientëve nuk kanë qenë të vaksinuar ose nuk i kanë pranuar të gjitha dozat sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit, ose nuk ka të dhëna për statusin e vaksinimit. (Grafiku 3).

Të vaksinuar me të gjitha dozat në përputhje me moshën janë 195 persona. (Grafiku 3).

**Grafiku 3.** Statusi i vaksinimit dhe moshja e të sëmurëve (n=489) me kollë të keqe në RMV, 2024



Nga të sëmurët në spital janë shtruar 69 persona (14,1%), ndërsa 55 (79,7%) prej tyre janë nën moshën 4 vjet. Numri më i madh i rasteve janë shtruar në KU për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët në Kozle. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të shtruar në spital, 61 janë lëshuar si të shëruar. Të sëmurët kanë qëndruar në spital mesatarisht nga 8 ditë.

Nga numri i përgjithshëm (n=489) i rasteve të regjistruara me kollë të keqe, 487 janë konfirmuar laboratorikisht, përkatësisht në Avicena (140), Institutin e Shëndetit Publik (119), Biotek (95), Sinlab (46), QSHP Kumanovë (24), SK Sistina (18), QSHP Manastir (15), Laor (10), Klinikën Zhan Mitrev (8), SK Manastir (5), Remedika (4), Pllodnost Manastir (2) dhe Ramus (1).

#### **Klasifikimi i rasteve:**

Sipas Rregullores për kriteret për definimin e rasteve të sëmundjeve ngjitëse (Gazeta Zyrtare nr. 19/2018), nga numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara (n=489) të kollës së keqe, 487 janë klasifikuar si raste të konfirmuara (të konfirmuara në laborator) dhe dy si të mundshme (ka një lidhje epidemiologjike me një rast të konfirmuar në laborator). Hetimet epidemiologjike tregojnë një lidhshmëri mes 88 rastesh.

Aktivitetet e realizuara për vaksinim me vaksinën e cila përmban komponentë të pertusis në Territorin e Qytetit të Shkupit dhe mbarë vendit

Në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Sëmundjeve Infektive dhe të Institutit të Shëndetit Publik, në periudhën nga data 18.01.2024 e deri më tani, në të gjitha pikat e vaksinimit në vend, në bashkëpunim me shërbimet epidemiologjike të QShP-së, është bërë hetim intensiv i të personave të pa evidentuar, personave të pavaksinuar dhe atyre të pavaksinuar plotësisht, si dhe personave që i nënshtrohen vaksinimit të rregullt, në mënyrë që të thirren dhe të vaksinohen sipas Kalendarit kombëtar të imunizimit.

*Shkup - numri i personave të vaksinuar në periudhën 18.01-18.04.2024*

Sipas të dhënave të siguruara nga ISHP Shtëpia e Shëndetit - Shkup, nga Shërbimi i Vaksinimit nga Gazi Baba dhe Çairi, Karposh, Kisella Voda dhe Qendra, është konstatuar se janë zbuluar 18.709 fëmijë që kanë lëshuar vaksinimin, dhe prej tyre janë vaksinuar 10.761 (57,5%). Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (5.515; 51,2%).

Sipas moshës dhe Kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 11.561 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (6.960; 60,2%) e fëmijëve të vaksinuar kanë marrë dozën II të revaksinimit në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në territorin e Shkupit në periudhën prej 18.01-18.04.2024 është 22.322.


*Maqedonia e Veriut (pa Shkupin) - numri i personave të vaksinuar nga 18.01-18.04.2024*

Nga të dhënat e deritanishme të dorëzuara nga Qendrat e Shëndetit Publik, 8.744 fëmijë kanë lëshuar vaksinimin, prej të cilëve 4.874 (55,7%) janë vaksinuar. Nga të vaksinuarit, numri dhe përqindja më e madhe ka marrë rivaksinimin e parë (2.438; 50,0%).

Sipas moshës dhe kalendarit të imunizimit të rregullt, janë vaksinuar 13.848 fëmijë nën moshën 7 vjeçare, ndërsa numri dhe përqindja më e madhe (7.106; 51,3%) e të vaksinuarve kanë marrë rivaksinimin II në moshën shkollore.

Numri i përgjithshëm i dozave të vaksinës që përmban komponentë kundër pertusis, të dhëna si vaksinim primar (doza I, II, III) ose rivaksinim (rivaksinim I, II) në periudhën nga 18.01-18.04.2024 është 18.722.

Grafiku 3. *Numri i dozave të administruara në Shkup dhe në qytetet e tjera në RMV, 2024*



## Përfundime

- Në vitin 2024 janë regjistruar 489 të sëmurë me kollë të keqe.
- Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në territorin e Shkupit (80.2%), ndërsa të sëmurë janë regjistruar në 16 qytete të tjera në RMV.
- Epidemi aktive ka në territorin e Shkupit dhe Kumanovës.
- Numri më i madh i pacientëve i përket grupmoshës 10-14 vjet (27.6%), incidenca më e lartë është regjistruar tek grupmosha nën 1 vjet dhe është 453,6/100.000 banorë.
- Nga numri i përgjithshëm i rasteve të regjistruara (489), 294 raste (60.1%) nuk kanë qenë të vaksinuar, nuk kanë qenë të vaksinuar sipas moshës së tyre ose nuk ka të dhëna për vaksinimin.
- Nga fëmijët që janë vaksinuar plotësisht (n=169), koha mesatare e kaluar nga doza e fundit e vaksinës deri në shfaqjen e sëmundjes është 12.8 vjet.
- Nga 489rastet e raportuara, në laborator janë konfirmuar 487 raste.
- Nga 18.01-18.04.2024, janë dhënë gjithsej 41.044 doza të vaksinës e cila përmban komponentë kundër kollës së keqe.

Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive  
ISHPRMV

19.04.2024